



ERMA SHEHU

Balancimi i Jetës Familjare dhe Karrierës përmes Marketingut Dixhital

Erma Shehu, një nënë e re dhe profesioniste në marketingun dixhital, ka arritur të balancojë jetën familjare dhe karrierën falë trajnimeve të ofruara nga Blinks. Pas kthimit nga Gjermania në Korçë, ajo u trajnua në marketingun dixhital dhe hapi një agjenci të suksesshme që ofron shërbime për një treg ndërkombëtar.

“Unë doja të trajnohesha në fushën e marketingut dixhital në mënyrë që të zgjeroja njohuritë e mia si eksperte e lirë.”

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT

Zbatuar nga:



HELVETAS
ALBANIA



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Kjo është Erma, nënë e re, e cila kishte 3 vjet që jetonte në Gjermani dhe e sapo kthyer në Korçë, ishte e qartë për punën që kërkonte. Si të ishte nënë pa ndërprerje dhe në punë me kohë të plotë. Ajo pati idenë se i duhej një profesion që t'ia siguronte këtë mundësi "dy-punësimi". Teamup.al e kontakton Emën dhe i bënë me dije asaj se mund të merrte pjesë në kurset e Blinks me fondet e mundësuar nga RisiAlbania.

Përmirësova aftësitë e mia dhe u informova mbi metodat e fundit në fushën e marketingut. Më pas, kisha kontakt të drejtpërdrejtë me një numër relativisht të madh klientësh. Këtë ekspozim nuk e kisha arritur dot para trajnimit. Arrita që sot të jem një freelancer, me një zyrë timen në të cilën ofroj shërbime të marketingut dixhital për një treg ndërkombëtar" thotë Erma, e cila të bën përshtypje se si stabilizoi jetën e saj private me atë profesionale duke qenë një nënë e re 33-vjeçare, në kohë të plotë, dhe njëkohësisht në punë, e sapo ardhur në qytetin e Korçës, ku punësimi i të rinjve është një problem që nuk zgjidhet lehtë.

"Pata nevojë për kurset që të mësoja trendet e fundit të industrisë ku synoja të zgjeroja aktivitetin tim, si dhe më ndërgjegjësoi për ekzistencën e një tregu mjaft të gjerë ndërkombëtar", thotë ajo. Pas dy vitesh, Erma hapi një zyrë ku ofroi shërbime mbi marketingun dixhital. Kjo zyrë shumë shpejt u shndërrua në një Agjenci të mirëfilltë marketingu dixhital me vendndodhje në qendër të qytetit të Korçës duke i shërbyer bizneseve të vogla dhe të mesme, kryesisht ndërkombëtare.

"Po, ndihem një rast i suksesshëm i RisiAlbania-s, sepse mendoj që jam trajnuar në mënyrë mjaft profesionale në një nga fushat më interesante në zhvillim dhe me një treg pune mjaft të gjerë dhe në rritje. Gjithashtu, ndihem rast suksesi sepse nëpërmjet këtij trajnimi arrita që të pozicionohem mjaft mirë në tregun e punës, si dhe të kem mundësi për të lëvizur lirisht në udhëtime pune apo edhe për turizëm si një nomade dixhitale", tregon Erma.

Agjencia e saj posedon sot një "portofol" prej më shumë se 500 klientësh, të cilët kryesisht kontraktjnë projekte të vogla tek ekipi i Blinks.

Agjencia e saj sot ka një zhvillim shumë dinamik në sektorin e TIK, pasi vendosi të nisë dhe zbatojë një linjë të re biznesi në trajnimin e të rinjve në Qarkun e Korçës në marketingun dixhital, duke u shndërruar në një mundësi të re për të rinjtë që kanë nevojë të punësohen në qytetin e Korçës.

Bashkëpunimi me Blinks për zbatimin e modelit të ri të biznesit shkon në përputhje me strategjinë e RisiAlbania-s në zhvillimin e aftësive për të zgjeruar mundësitë e ofrimit të trajnimeve jashtë Tiranës. Blinks është ndër kompanitë e para që fokusohet dhe operon në Korçë në këtë sektor dhe pritet të bashkëpunojë ngushtë me kompanitë e TIK.

Për Ermën ishte një përvojë e vlefshme ku brenda një kohe të shkurtër fitoi disa aftësi të synuara profesionale, takoi njerëz kreativë me synime dhe ide shumë inovatore me të cilët mban akoma sot kontaktet. Erma u pozicionua në tregun e punës si një nënë e re, e cila kthehej në Shqipëri pas një periudhe shkëputjeje gati 3-vjeçare në Gjermani. Blinks Hub, një agjenci marketingu dixhital e vendosur në Korçë, u shërben bizneseve të vogla dhe të mesme në mbarë botën. Me mbi 500 klientë të shërbyer dhe një shkallë suksesi prej 90%, shumica e klientëve janë të kthyer që përdorin shërbimet për më shumë se 6 muaj. Ekipi përbëhet nga 3 dizajnerë grafikë dhe 2 shkrimtarë përmbajtjes, duke shërbyer rreth 50 bizneseve në muaj. Me kërkesën në rritje për shërbimet e marketingut dixhital, Blinks Hub ka përfutur nga mbështetja e RisiAlbania, e cila përfshin studimin e tregut mbi nevojat për aftësi në marketingun dixhital, rritjen e kapaciteteve të trajnerëve përmes sesioneve TOT dhe zhvillimin e 4 kurrikulave mbi aftësitë e marketingut dixhital, duke përfshirë marketingun dixhital dhe të mediave sociale për biznes, optimizimin e motorëve të kërkimit, vendosjen dhe zbatimin e fushatave të reklamimit të paguar për mediat sociale dhe aplikacionet e dizajnit grafik për mediat sociale.

